

Habitatet

vendet ku ne mund të jetojmë e të rritemi

Gjithçka në planetin tonë, duke filluar nga gjitarët e mëdhenj dhe shpendët, për të vazhduar me amfibët, reptilët dhe bimët, e deri tek kërpudhat, si dhe mikro-organizmat, kanë nevojë për një vend që ta quajnë shtëpi, njësoj siç njerëzit bëjnë. Çdo organizmi i nevojitet një vend ku të jetojë, i cili ofron ushqim, ujë, hapësirë, strehë, si dhe kushtet e duhura për tu riprodhuar. Ne i quajmë këto vende 'habitate', ku secili prej tyre ofron një hapësirë të caktuar, me kushte të përshtatshme, për jetesën e të gjitha llojeve të bimëve dhe kafshëve. Lloje të ndryshme janë përshtatur për të jetuar në vende tërësisht të ndryshme - imagjino një lepur në det të hapur, apo një ari polar në një plazh tropikal, asnjëri prej tyre nuk do të mbijetonte. Në brendësi të një pylli, llojet që jetojnë sipër pemëve nuk mund të gjenden edhe në rrënjët e tyre, apo në sipërfaqen e dheut përreth - secila pjesë ka një komunitet të përcaktuar organizmash që jetojnë aty, pikërisht prej kësaj ne mund t'i dallojmë si hapësira të ndryshme prej njëra - tjetrës.

Një vështrim më i afërt - tipet e habitateve

Kur na duhet të studiojmë apo hartëzojmë vende të cilat lloje të ndryshme i përdorin për strehim dhe sigurim ushqimi, sidoqoftë, ne mendojmë për to në një tjetër mënyrë - ajo çfarë vështrojmë janë llojet e ndryshme të bimëve që rriten aty dhe, duke u bazuar në kombinimin e tyre, arrijmë të klasifikojmë vendet ku ato bashkëjetojnë. Të tilla kombinime na ndihmojnë për të përshkruar ato çfarë ne quajmë "tipe habitatesh", pra çfarë lloji hapësire ai përfaqëson. Lloje të ndryshme bimësh preferojnë kushte të caktuara për tu rritur, duke u grupuar në ato çfarë ne quajmë "komunitete bimore" - të tilla kombinime tregojnë një histori të cilën specialistët e bimëve mund ta dëshifrojnë dhe të na e tregojnë, duke pohuar tipin e habitatit ku këto lloje jetojnë. Kur një habitat është i rëndësishëm, ai mbrohet prej ligjeve kombëtare, evropiane, apo edhe më gjerë, në mënyrë që të përfitojnë si njeriu ashtu edhe natyra. Brenda Bashkimit Evropian, rrjeti i Natura 2000 e përmbush më së miri këtë rol.

Tipet më të rëndësishme të habitateve përbëhen nga kombinime të veçanta të bimëve, qoftë prej pranisë së llojeve të rralla, apo prej faktit që ndryshimet në peizazhe kanë lënë pak habitate të paprekur. Nën sistemin e Natura 2000, komunitetet më të rëndësishme të bimëve njihen si "tipe habitatesh prioritare", të cilat gjenden edhe në liqenin e Prespës, në të tre anët e tij. Sigurisht, rëndësia shkencore nuk është i vetmi tregues i rëndësisë së bimëve dhe habitateve. Ne vlerësojmë, gjithashtu, fushën tonë të preferuar nga ku marrim përbërësit për të gatuar drekën, vendin tonë sekret ku gjejmë bimë mjekësore, shtigjet që përshkojmë në kërkim të frymëzimit, si dhe natyrën ku fëmijët tanë luajnë me njëri-tjetrin.

Vendet e veçanta në Prespë dhe tipet e habitateve

Ne të gjithë e dimë që Prespa është e jashtëzakonshme, për shumë arsye, dhe kjo nuk mund të ndryshojë kur flitet për tipet e habitateve, për arsyen se Prespa është shtëpi e disa prej tyre. Kjo vjen për shkak të vendndodhjes së saj - pjesërisht afër Mesdheut dhe pjesërisht afër Evropës Qendrore - si edhe prej përbërjes gjeologjike, çfarë bën që një numër i lartë llojesh bimore mund të jetojnë në një zonë relativisht të vogël, si Prespa. Këtë mund ta dëshmojmë ndërkohë që ecim përgjatë saj; këtu kemi ah, atje dëllinjë, në një tjetër vend dushaqe, drurin e të cilave mund ta përdorim për ngrohje gjatë dimrit, etj. Nëse brenda kësaj përzierjeje do të shtojmë klimat e ndryshme të ndikuara prej liqeneve, si dhe shtrirjen e gjerë në lartësi, nga ligatinat deri në majat e maleve, nuk është çudi që aty ka një varietet të gjerë tipi habitatesh. Disa prej tyre mund të gjenden në të tre shtetet të cilat kufizojnë liqenin, ndërsa të tjera janë specifike vetëm në një pjesë, në varësi të kushteve të caktuara që ekzistojnë aty. Në hartën e gjendur në pjesën e pasme mund të shikoni disa nga tipet e habitateve më të veçanta në Prespë, në secilin prej vendeve të cilët ndajnë basenin e liqenit, si dhe disa nga llojet më të bukura të gjendura në to. Ndani me ne vendet dhe bimët tuaja të preferuara duke përdorur hashtagun #presaplantplaces!



© S. Nadev



© Foto: Marqab

Njerëzit, bimët dhe Prespa - puna e PrespaNet mbi tipet e habitateve

PrespaNet në vitet e fundit ka punuar për të zbuluar më tepër rreth basenit të liqenit, duke hartëzuar tipet e veçanta të habitateve dhe duke e shpërndarë njohurinë me menaxherët e parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura. Përpjekjet kanë filluar për të restauruar disa nga këto vende të rëndësishme, në mënyrë që ti jepet një nxitje biodiversitetit, veçanërisht pyjeve me vërrë të Parkut Natyror të Ezeranit.

Habitatet si dhe tipet e tyre kanë qenë në zemër të aktiviteteve tona të edukimit natyror për të rinjtë, ku ndër të tjera, mund të përmendim një program të fokusuar tërësisht në ekologjinë e bimëve të egra dhe rëndësinë e tyre për të gjithë vendet e veçanta në Prespë. Ndërkohë, Programi "Ana e Egër e Prespës", ka afruar të rinjtë e Resenit me terrenin, i ka lidhur me natyrën, duke i shndërruar në vullnetar energjik brenda grupeve tona. Pavarësisht listës së gjatë të arsyeve mbi rëndësinë e habitateve si dhe tipeve të tyre, më kryesorja qëndron në faktin se ato shërbejnë si shtëpi për gjallesa të ndryshme, qofshin kafshë apo bimë, insekte apo shpendë, apo edhe njerëz - ne të gjithë e themi që nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa shtëpia!



PrespaNet është një rrjet organizatash jo qeveritare mjedisore për Prespën; SPP, e vendosur në Agios Germanos e cila punon në zonë pothuajse për 30 vjet; MES, një nga organizatat më të vjetra në vend, me zyrë qendrore në Shkup dhe me zyrë lokale në Resen; dhe PPNEA, organizata e parë mjedisore në Shqipëri, që punon prej mesit të viteve '90 me palët e interesit në rajonin e Prespës, me seli në Tiranë dhe një zyrë lokale në Prespë.

Të tre këto organizata janë duke punuar së bashku mbi projektin 3 vjeçar "Ruajtja dhe mbrojtja e natyrës në basenin ndërkufitar të Prespës nëpërmjet forcimit të rrjetit të organizatave mjedisore", i financuar nga Fondi i Besimit për Natyrën e Ohrit dhe të Prespës dhe Fondacioni Bamirës Aage V. Jensen, me mbështetjen e Fondacionit EuroNatur. Projekti ka si qëllim të rrisë veprimet për ruajtjen e natyrës dhe bëshkëpunimin ndërkufitar në basenin e Prespës.



Në këtë hartë tregohen disa prej vendeve tona të preferuara në Prespë, si dhe llojet bimore të cilat mund të gjenden aty – Përse nuk del të eksplorosh nga afër disa prej tyre, më pas na trego të preferuarat e tua në #presaplantplaces!



Druri i dëllinjës (*Juniperus sp.*) mund të gjendet në të tre anët e liqenit, i përshtatur në mjediset e thata gëlqerore në krahun perëndimor të basenit. Grupime drurësh të lashtë gjenden pranë kishës së Agios Georgios në anën greke të Prespës, si dhe në ishullin e Golem Grad në Prespën e Madhe. Ky ishull është gjithashtu shtëpi për qindra breshka të tokës (*Testudo hermanni*), meshkujt e të cilave i kalojnë femrat në një raport 10 me 1, ndërkohë që disa prej dëllinjave shërbejnë si habitat folezues për karabullakun e madh (*Phalacrocorax carbo*).



Përreth anës lindore të liqeneve në Maqedoninë e Veriut, si dhe në tokën midis liqeneve në Greqi, shtrihet një rrip ranor me bimësi të ulët, i cili është habitat prioritar sipas direktivës Evropiane, për arsye se është tepër i rrallë. Ky peizazh me rërë është i mbuluar me ngjyrat e pranverës dhe të verës; ndër të tjera, ky vend është shtëpi për një bimë endemike të Gadishullit të Ballkanit, *Silene frivaldszkyana*, e cila çel nga Qershori deri në Shtator.



Përgjatë basenit gjenden fragmente të pyjeve me vërrë, një tjetër tip prioritar habitatit sipas direktivës së BE-së, i cili gjendet me një sipërfaqe modeste në anën shqiptare të Prespës së Vogël, në rrjedhën e Mikrolimni-it në Greqi, si dhe me një grupim pemësh të lashta në Parkun Natyror të Ezeranit. Tradicionalisht i përdorur për të ndërtuar varka dhe mobilje në Maqedoninë e Veriut, tashmë *Alnus glutinosa* gjendet nën rrezikun e pastrimit për qëllime të agrikulturës. PrespaNet është duke e restauruar këtë tip pylli duke përdorur fara të mbledhura në Ezerani, të cilat kemi shpresë se do të mbrojnë e shpërndajnë diversitetin gjenetik të këtij lloji vulnerabël druri të vjetër.

Për informacion më të detajuar përpara se të vizitoni ndonjë nga këto zona, ju lutemi të kontaktoni zyrat e partnerëve lokal të rrjetit PrespaNet.

PPNEA (AL)
(0355) 562 8954
contact@ppnea.org

SPP (GR)
(0030) 23850 51211
spp@line.gr

MES (MKD)
(0389) 2 2402 773
contact@mes.org.mk



Prespa është shtëpi e një grupimi mbresëlënës ligatinash përreth liqeneve, me shtretër të dendur kallamishtesh në të tre anët e saj. Në Greqi këto vende janë shtëpi për shpendë ujor të rrallë si karabullaku i vogël, lloje të ndryshme çafkash dhe kryekuaja e vogël, duke përfshirë koloninë më të madhe të pelikanit kaçurrel në të gjithë botën! Me një hapje krahësh prej gati 3 metër, pelikanët janë një pamje që nuk duhet humbur ndërsa fluturojnë mbi shtretërit e kallamishteve.



Shkëmbinjët përreth bregut të liqenit, pothuajse të zhveshur nga bimësia, shërbejnë si shtëpi për *Algyroides nigropunctatus*, një zvarranik i gjendur më së shumti në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit, përgjatë Gadishullit të Ballkanit. Për arsye të izolimit, ky zvarranik është vlerësuar si i rrezikuar në Listën e Kuqe Kombëtare në Maqedoninë e Veriut, i cili për shkak të ijeve me ngjyrë të kuqe, është tepër interesant për tu parë.



Malet të cilat rrethojnë liqenet janë shtëpi për pyjet e larta të ahut, të cilat gjenden me sipërfaqe të konsiderueshme në pjesën lindore të basenit, të pasuara nga shpatet e Malit të Thatë në Shqipëri, ku kombinohen me bredhat e bardhë dhe ata Bullgarë.



Sipër liqeneve, malet e Prespës janë të mbuluar me kullota. Livadhet sub-alpine, në anën lindore të majave prej graniti, në periudhën e fundit të pranverës dhe fillimit të verës, shërbejnë si vend grumbullimi për bimë të egra me lule shumëngjyrëshe, të cilat tërheqin një mori fluturash. Habitatet e tjera, në malet karstike të anës perëndimore të basenit, janë po ashtu të bekuara, pikërisht këtu mblidhet edhe një pjesë e konsiderueshme e çajit të malit në rajon.

